



Npi – 01/120 datë: 20.04.2021

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 20.04.2021 është nxjerrë ky:

**E K S T R A K T**  
**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË -IV- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES**  
E mbajtur më: 20.04.2021, (e martë) në ora 10.<sup>oo</sup> h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: znj.Medina Brahaj, z.Perparim Ramusa, z.Shefki Dauti, z.Herolind Selmani, z.Reshat Mujota, z.Milot Deliu, znj.Fatmire Ferati, znj.Arbenita Halimi, z.Naim Zejna, z.Skender Hyseni, znj.Zarife Rexhaj, znj.Valentina Halili-Ferati, z.Ruzhdi Jashari, z.Besnik Seferi, znj.Marigona Pajaziti, z.Fehmi Hysenaj, znj.Adelina Beqaj, z.Isak Muslija, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, dhe z.Rexhep Gashi.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstattoj, Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje dhe mund të vazhdojmë me mbledhjen. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**REND DITE**

1. Pyetje- përgjigje,
2. Shqyrtimi për miratimin përfundimtar për dhënien në shfrytëzim për 99 vite, pjesën e parcelës nr. P-72809029-00230-0 me sipërfaqe prej 35231m<sup>2</sup> në zonën kadastrale Dugë te vendi i quajtur “Kodra e Mustabashit” dhe parcelën me nr. P-72809029-00251-0 me sipërfaqe prej 3859m<sup>2</sup> në zonën kadastrale Dugë te vendi i quajtur “Ahishte për mbi shpi”.
3. Propozim-Vendim për këmbim të pronës së paluajtshme komunale sipas Vendimit të Kuvendit Npi-01/272, date 24.11.2020,
4. Propozim-Vendim për shpalljen me interes publik të ngastrave kadastrale Rancë, Rrugë, Nr.372/0, 373/0, pronë e Salih Halili dhe Shaban Halili — Rancë,
5. Propozim-Vendim për ndryshim të destinimit të shkollës dhe oborrit të shkollës në Llanisht,
6. Caktimi i lokacionit për vendosjen e shtatores së “Adem jasharit”,
7. Informatë e përgjithëshme nga drejtoria për inovacion.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Fillimisht konstatoi se në mbledhje prezantojnë të gjithë delegatët e Kuvendit dhe pas sqarimit për shtyrjen e kësaj mbledhjeje, hapi diskutimin për rendin e ditës.

**z.Rexhep Gashi;** Materialin e kemi marrë me kohë. Rendi i ditës nuk është në bazë të Planit të punës ku kemi pasur për këtë muaj 4 pika. Këto pika kanë qenë të rëndësishme që të ihen në rend dite. Nuk kemi asnjë pikë për pandeminë, që ende është aktuale.

Lidhur me këtë Kryesuesja sqaroi se jo 100% janë përcjellur pikat nga plani i punës, por 90% mesiguri që po.

**z.Ruzhdi Jashari;** Kërkoj që pika 2,3,4 dhe 5 të hiqen nga rendi i ditës për shkak të mosrespektimit të Rregullores së Qeverisë lidhur me dhënien e pronës pasi që edhe mungon një listë paraprakisht e aprovuar nga Kuvendi për pronat që mund të jepen në vitin 2021. Planin e punës së Kuvendit parasheh pika të tjera kurse në këtë rend dite janë futur pronat. Kush nuk mund të presë në lidhje me pronat apo këmbimin etyre, le të shkojë në gjyq. KPF është organ që jep mendimin për pikat e rendit të ditës e jo kryetari.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Tha se ne e përcjellim Planin e Punës së Kuvendit, por kur janë në pyetje interes e qytetarëve atëherë kemi edhe pika që duhet t'i shqyrtojmë e që edhe sot i kemi në rend dite.

**z.Fehmi Hysenaj;** Përshëndetje për të gjithë.Ju uroj ramazanin të gjithë adhuruesve. Kemi marrë materialin me kohë. Pajtohem me pikat e rendit të ditës.

**z.Përparim Ramusa:** Pajtohem me rendin e ditës që është propozuar. Arsyetimi i kolegëve se është vit zgjedhor nuk qëndron pasi që kemi pasur edhe më heret situatë të këtilla lidhur me pronat.

**z.Shefki Dauti:** Mendoj se jemi në pajtueshmëri me pikat e rendit të ditës. Pajtohem me rendin e ditës.

**z.Naim Zejna:** Mungon procesverbali nga mbledhja e kaluar. Për rastin e pronave unë kam propozuar të hiqen nga rendi i ditës pikat 2,3,4,5 sepse kjo reflekton keq te qytetarët kur këtë vit kemi zgjedhjet. Nuk jam për këtë rend dite.

**Kuvendi i Komunës aprovoi rendin e ditës.**

#### Pika 1

#### Pyetje – Përgjigje

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Naim Zejna;** Nëse tani marrim përgjigje në pyetjet e shtruar nga mbledhja e kaluar e jo si më parë me shkrim, atëherë bëjmë shkelje të rregullave të Kuvendit. Pse nuk i kemi përgjigjet me shkrim kur ashtu jemi marrë vesh?

**z.Shefki Dauti;** propozoi të votohet, nëse duhet, sea do të kemi përgjigje me shkrim apo përgjigje direkte, mirëpo Kryesuesja sqaroi se për këtë çështje Kuvendi ka vendosur qysh më parë dhe se nuk ka nevojë të votohet.

#### Pyetjet që u shtruan:

**z.Shefki Dauti;**

Çfarë po ndodh me objektin e stacionit të vjetër policor, në Shtime? A ka ndojë plan konkret sepse shumëherë kemi diskutuar. Qytetarët duhet të dinë?

Rruga Luzhak-Topillë pse ka mbetur në gjysmë,A ka plan konkret kur do të asfaltohet ajo rrugë?

Para disa vitesh kemi votuar që të bëhet një kompani publike për mirëmbajtjen e varrezave,çfarë kanë ndodhur sepse nuk kemi asnjëinformata në Kuvend për këtë?

Vendin që e kemi përcaktuar për mbeturina nuk shfrytëzohet për atë qëllim. Kemi ankesa të qytetarëve për mbeturinat që po hedhën nëpër ara. Dua të di çfarë ka ndodhë me atë deponi të përcaktuar dhe çfarë procedura janë zbatuar.

Në Caralevë, Lagja “Shaqiri” për shkak të vërshimeve të fundit janë shpluar gypat dhe i ka marrë uji. Kanalizimi derdhet në ara private. Dua të di kur do të intervenohet pasi që u është premtuar qytetarëve kur dihet se ata do të fillojnë mbjelljen dhe duhet të dine për këtë?

**z.Fehmi Hysenaj;**

1.Kërkoj nga kryetari i komunës ose vartësit e tij DSHP të përshkojë me veturë rrugën “Ahmet Shtimja”, në drejtim të fshatit Petrovë. Një pjesë ka mbetur e paasfaltuar e panjohur për ne. Pse, dhe kur do të përfundojë?

2.Edhe përkundër investimeve marramendëse palestra sportive ka mbetur në gjendje të mjerueshme. Ankesat e disa klubeve dhe ankesat e futbollit janë të panumërta si mungesë e ndriçimit në sallë e të mos flasim për korridore. S’ka fare ndriçim në koridore. Pastaj problemi me reflektorin. Zhveshtorja është në gjendje të keqe .

3.Parkingjet publike ,çka po ndodhë? Kush i menaxhon ato? Pse nuk zbatohet asnjë vendim i KK-së?

4.Sa janë të hyrat nga bizneset që shfrytëzojnë hapësirat publike duke përfshirë edhe ato për shfrytëzim afatëgjatë. Kërkojë që deri në mbledhjen e ardhshme të na dergohet lista e tyre dhe shumat që kanë për pagesë.

5.Pse në tualet e Kuvendit nuk ka asnjëherë letra dhe material tjetër higjienik si dhe mungesë e shamponit et?

**z.Muhamet Ademaj;**

1.A ka plan për pastrimin e mbeturinave?

2.Pse nuk rrespektohet ligji për ndalimin e pirjes së duhanit në vendet publike?

3.Pse nuk ka ujë të pijshëm në rrugën “EçremQabej”,në Shtime.

**z.Skender Hyseni;**

Kam pyetje lidhur me kanalizimin dhe depërtimin e ujit në oborre të shtëpive, në Muzeqinë. Ende nuk është ndërmarrë asgjë. Kur do të zgjidhet kjo çështje?

**z.Ruzhdi Jashari;**

Nuk kemi marrë informacione për mjetet e rrugës “ AhmertShtimja “, kjo ka qenë pyetja që nuk kam marrë ende përgjigje.

Kërkoj me shkrim të gjitha vendimet që ka marrë Kuvendi e që nuk janë zbatuar. Pse nuk janë zbatuar?

Komuna ka pasur pajisje, kompjuterë, llaptopë etj ndërsa ka marrë me qira pajisje të teknologjisë informative. Kërkoj një regjistër të pajisjeve teknologjike që kemi marrë me qira sidomos në arsim dhe shëndetësi. Gjithashtu kërkoj një regjistër të automjeteve të marra me qira. Përse automjetet me qira kur kemi ndarë buxhet për blerjen e automjeteve. Pse tash me qira merren? Duhet ta dimë kompaninë të cilësi jep komuna mjete për qira dhe pse?

Çfarë ka bërë inspektorati lidhur me pronën e uzurpuar nga Sadik Abazi, cili është vendimi konkret dhe a kanë liruar atë pronë që është uzurpuar jashtëligjshëm, me vendim të KK-së.

**z.Milot Deliu;**

Sa është numri i stafit të QKMF-së pasi që jemi ende në kohën e pandemisë dhe a është i mjaftueshëm? Sa është numri?

A janë vaksinuar stafi i QKMF-së. Sa është numri i të vaksinuarve?

**z.Naim Zejna;**

1. Për kryetarin e komunës:Pyetja ka të bëjë me pronën e Sadik Abazit 333/5,Rr-“Tirana”, Rr-“Adem Jashar” dhe rruga Transít, 30 ari, e uzurpuar nga Sadik Abazi që tani e 20 vjet. A ka ndërmarrë inspektorati diçka? Cilin veprim e ka ndërmarrë dhe në cilën fazë është? Kam informacion se nuk është ndërmarrë asgjë.

2.Kamerat në shkollën profesionale është shumë e nevojshme sikurse edhe shkollat tjera. A janë në plan të funksionalizimit?

3.Pagat jubilarë nuk paguhen vetë në komunën e Shtimes dhe kerkohet me gjyq ekzekutimi i tyre përmes ankesave ndërsa komunat e tjera e bëjnë këtë. Përse?

4.Kemi formuar komisionin për banesat e “Fitores”. Në cilën fazë të punës është komisioni ,a ka bërë ndonjë konstatim sa është prona e komunës dhe kujt do t’i destojë ato banesa?

5. Është një pusëtë te ura dhe me DSHP kemi diskutuar. Është e hapur ende nga punimet që i ka bërë “ Fitorja “. Nuk është mirë që tani e 7-8 muaj një pusëtë të mos rregullohet. Çka do të ndërmerret?

**z.Besnik Seferi;**

1. Për QKMF-në: Çka po ndodh me pagat e stafit esencial të angazhuar në kohë pandemisë?
2. Për DPUKGJ: Kur do të fillojnë punimet në Rr. “ Ruzhdi Salihu “, në Shtime. A ka planifikim të zbatueshëm të projekteve sepse shumica nuk kryehen në afatin e paraparë.
3. Për DKRS: QR është në gjendje të mjerueshme. Aty janë zhvilluar aktivitete të shumta nga OJQ-të. Ajo tani është në demolim total. Çka është plani i DKRS-së për këtë objekt?
4. A janë zgjedhur sportistët e vitit për vitin që shkoj .Dihet që shumë sportistë të Komunës tonë po marrin medalje në shumë nivele jashtë Kosovës. Sa i kemi motivuar të rinjtë që po marrin medalje të arta në nivele të Kosovës. Kemi rastin e të riut nga fshati Godanc që ka marrë medalje të artë në gjimnastikë dhe së fundi kemi 3 medalje të arta nga të rinjtë dhe nuk e di a stimulohen këta të rinj të Komunës sonë.

## Pika 2

Shqyrtimi për miratimin përfundimtar për dhënien në shfrytëzim për 99 vite, pjesën e parcelës nr. P-72809029-00230-0 me sipërfaqe prej 35231m<sup>2</sup> në zonën kadastrale Dugë te vendi i quajtur “Kodra e Mustabashit” dhe parcelën me nr. P-72809029-00251-0 me sipërfaqe prej 3859m<sup>2</sup> në zonën kadastrale Dugë te vendi i quajtur “Ahishte për mbi shpi”.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Njoftoi se për Shqyrtimin për miratimin përfundimtar për dhënien në shfrytëzim për 99 vite, pjesën e parcelës nr. P-72809029-00230-0 me sipërfaqe prej 35231m<sup>2</sup>, në zonën kadastraleDugë te vendi i quajtur “Kodra e Mustabashit”, dhe parcelën me nr. P-72809029-00251-0 me sipërfaqe prej 3859m<sup>2</sup>, në zonën kadastraleDugë te vendi i quajtur “Ahishte për mbi shpi”, Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “ për “( me votën e dyfishtë të Kryesueses ) dhe 3 vota “ kundër “, vendosi t’i rekomandojë Kuvendit marrjen e vendimit përfundimtar për dhënien në shfrytëzim të parcelave të lartëcekura.

Diskutime:

**z.Perparim Ramusa;** Kërkoj që paraprakisht të marrim një sqarim nga Valentina pasi që ajo ka qenë anëtare e komisionit.

**z.Fehmi Hysenaj;** Ende nuk jam i bindur se duhet të aprovohet kështu ky Propozimvendim. Çertifikata e biznesit tregon se ky biznes është themeluar në vitin 2020 dhe se janë dy pronarë me kapital 100€. Aktivitetet që janë prezantuar të bëjnë të dyshosh se kemi të bëjmë me biznes serioz. Pastaj përfaqësuesi i SHC nuk e ka nënshkruar miratimin në komision. Nuk është prezantuar projekti para palëve të interes, në këtë rast edhe para Kuvendit. Mendoj se vendimi i komisionit duhet të jetë i nënshkruar nga 5 anëtarët, pra , edhe nga SHC, që nuk e ka nënshkruar. Është mirë që fillimisht të prezantohen këto në Kuvend dhe gjithashtu para palëve të tjera të interes.

**znj.Valentina Halili-Ferati;** E kemi shpallur njoftimin publik dhe kemi publikuar kriteret. Investimet kanë qenë mbi 100 mijë euro dhe numri i të punësuarve 70. Si komisionit ku kam qenë kryesuese, e kemi vlerësuar me 85 pikë. E kemi edhe raportin përfundimtar.

**z.Naim Zejna;** Ivestimi prej 980 mijë euro është i dyshimtë pastaj pse t’i jepet për 99 vite pa pasur siguri për investime, e jo psh. për 10 vite. Dyshimi është se autostrada do t’i bie në këtë pjesë prandaj ka dyshime për përfitime. Nuk është mirë të thirremi në ligjin për dhënien e pronave për 99 vite sepse nuk është në rregull dhe jam kundër diskutimeve për dhënien e tokës, në këtë kohë.

**z.Ruzhdi Jashari;** Kemi edhe informata se do të nisë autostrada nga aeroporti në këtë drejtim. Sipas parametrave ajo kalon andej. Nuk e kemi rastin t’i japim këtë pronë askujt. Pastaj mungojnë 2 emra të anëtarëve të komisionit. Mungon konkurrenca, sa firma kanë konkurruar. Biznesi starton në vitin 2023, pse ? Këto janë fakte që ky projekt është i fushatës dhe asgjë tjetër.

**z.Fehmi Hysenaj;** Duhet ditur edhe rrezikun. Firma me kapital 100€ nuk është serioze. Kjo nuk meriton as të diskutohet në këtë mbledhje.

**z.Muhamet Ademaj;** Po flasim për një pronë që ka sipërfaqe bukur të madhe, mbi 3 ha dhe është mirë të kursehet kjo pronë për gjeneratat e ardhshme. Pse t'i jepet për 99 vite . Unë jam që t'i jepet për 10 vite dhe sipërfaqe vetëm 1 ha.

**z.Perparim Ramusa;** Ne kemi formuar komisionin që na ka sjellur një raport të detajuar. E dimë se nëse brenda gjasht muajsh nuk fillon investimi, mund ta marrim prapë atë pronë. Unë jam që t'i jepet prona për 99 vjetë.

**z.Shefki Dauti;** U tha se mund t'i marrim pronën pas 6 muajsh nëse nuk fillon investimi prandaj të specifikohet se nëse nuk fillon investimi brenda 6 muajsh atëherë merret prona. Ne po i zgjasim investimet për dy vite, por nëse nuk fillon fare investimi brenda 6 muajsh dhe nëse nuk punëson numrin e punëtorëve sa ka deklaruar atëherë t'i merret prona.

**z.Besnik Seferi;** Do të mbahet mend ky Kuvend për dhënie të pronave dhe shpronësime. Shpresoj të mos ketë përfitime personale këtu. Ka shumë dilemaqë të japim këtë pronë. Po flitet për investime në vitin 2023 e jo në 2022. Dy vite mbetet pezull kjo pronë, pa investim. Këtu ka dilema. Prona komunale duhet të jepet për interes të përgjithshëm dhe jo përfitime personale.

**z.Shefki Dauti;** Brenda 6 muajsh duhet të fillojë investimi kurse brenda 2 vitesh duhet të investohet ajo çka është planifikuar. Kjo duhet të specifikohet qartë.

**z.Skender Hyseni;** Mungon zyrtari ligjor që të na sqarojë këtë çështje. Tani doli edhe dilema e autostradës, kush i bart pastaj pasojat nëse ndodh kjo.

**z.Ruzhdi Jashari;** Në raport thuhet të fillojë investimi në vitin 2023. Kjo është një lojë e kryetarit të komunës. Nuk ka investim për 6 muaj, siç po thuhet. Pse t'ia japim tani pronën.

**z.Isak Musliu;** Kuvendi që nga themelimi ka pasur lëvizje të kalimit nga partia në parti dhe kjo ka shkaktuar probleme me marrjen e vendimeve.

**z.Fehmi Hysenaj;** Mundësia është që t'i japim shansin që të prezantojë projektin para Kuvendit dhe qytetarëve. Vetëm atëherë sqarohen dilemat dhe mund të marrim vendim nëse konsiderojmë se është investim serioz dhe në interes të qytetarëve.

**z.Naim Zejna;** Pse nga DPUKGJ-ja nuk na sqarohet se a ka plan të kalojë autostrada apo jo në atë pjesë. Investimet në 3 ha të komunës çka i duhen kur ka 20 ha të vetat.Dyshimi është këtu. Asnjë biznes nuk e kemi kthyer në pikën 0 kur i është dhënë prona.

**z.Perparim Ramusa;** Investimet janë 980 mijë euro. Nëse nuk fillor investimi brenda 6 muajsh atëherë le të mbetet që t'i merret prona.

**z.Milot Deliu;** Nuk mund të akuzojmë një biznes kur nuk kemi shpallje për investim. Investimi për një vit është i vështirë sepse ka procedura që kërkojnë kohë, së paku një vit.

**z.Shefki Dauti;** Kemi pasur të njëjtin rast në 2012/2013 dhe i kemi marrë parcelën pasi që nuk ka investuar. Nëse investon atëherë mirë, nëse jo i marrim brenda 6 muajsh.

**z.Muhamet Ademaj;** Nëse në atë pjesë bie autostrada të na njoftojë DPUKGJ-ja.Jam për shtyrje të kësaj pike.

**z.Isak Musiliu;** Kemi vendim që është kthyer prona ku nuk ka filluar investimi, p.sh Demokrat Mujota.

**z.Shefki Dauti;** Kemi raste në Parkun e biznesit kur i kemi marrë pronën e dhënë pas afatit të paraparë për investime.

**z.Naim Zejna;** Këtu kemi garancionvëtem 100E nga ky biznes. Nuk jam që në këtë kohë të jepet prona.

**z.Reshat Mujota;** Demokrat Mujota e ka kthyer pronën sepse ka dështuar projekti. Sa është marrë vendim për kthimin besoj se është kryer procedura.Drejtori i DZHE-së obligohet të jetë prezent dhe të na japëshpjegim lidhur me investimet e planifikuar në këtë prone për të cilën po diskutojmë.Skagarancion për investime tani për tani.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi se janë 20 delegatë prezentë në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës, me 12 vota “Për” me 3 vota “Kundër” dhe me 5 vota “Abstenim”, Aprovoi Vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, pronën e paluajtshme Komunale, me sipërfaqe të përgjithëshme prej: 39090 m<sup>2</sup> (3 hektar 90 ari e 90 metra katror), në Zonën Kadastrale – Dugë, firmës “CUBAT” SH.P.K, i cili nga Komisioni Vlerësues ka fituar gjithsej 85 pikë. me përfaqësues z.Eqrem Krasniqi, dhe Brikena Almina, Adresa: Fshati Dugë-Shtime.

(Fehmi Hysenaj, Ruzhdi Jashari, Besnik Seferi, Naim Zejna ), Abstenim 4 vota ( Muhamet Ademaj, Skender Hysenaj, Rexhep Gashi, Reshat Mujota ).

### Pika 3

#### Propozim-Vendim për këmbim të pronës së paluajtshme komunale sipas Vendimit të Kuvendit Npi-01/272, date 24.11.2020.

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Fillimisht ka dhënë sqarimet e nevojshme lidhur me Propozim-Vendimin për këmbim të pronës së paluajtshme komunale, sipas vendimit të Kuvendit Npi-01/272, të datës 24.11.2020 duke bërë edhe njoftimin se Komiteti për Politikë dhe Financa, me shumicën e votave: 5 “ për “ dhe 1 “ kundër “, i ka rekomanduar Kuvendit që për Propozim-Vendimin për këmbim të pronës së paluajtshme komunale, në këmbim të përfshihet komplet parcela me numër P-333/3 dhe pjesa e mbetur të merret nga P-333/4 (të fillohet në kufinjë të parcelës fqinje-Sadik Abazit).

Diskutimet:

**z.Isak Musliu:** Në këtë rast konsultimet me grupet parlamentare është vendim i gabuar I Kryetarit për të marrë vendime të gabuara.

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Kemi këtë kërkesë për Kuvendin dhe e kam konsultuar edhe me Kryetarin, prandaj e kemi vënë për shqyrtim në rendin e ditës.

**z.Reshat Mujota:** Jam kundër diskutimit për këtë pikë.Asambleistëti ndërrojnë qendrimet e veta prandaj tani heshtin kur kemithenë se kjo çështje duhet të hiqet nga rendi i ditës.Nuk kemi asnjë deklaratë të urbanizmit se a është prona e uzurpuar më herët dhe tani ta mbulojmë me këmbim.

**z.Shefki Dauti:** E kemi shtyrë këtë çështje për të gjetur zgjidhje.Nëse ai ka qenë uzurpim nuk kemi procedura të dënimit.Urbanizimi nuk e konsideron problem këtë. Jam që të votohet në formatin e kaluar siç ekemi bërë më herët.

**z.Ruzhdi Jashari:** Ka përgjëgjësi ekzekutive këtu.Neve si Kuvend këtu na cenohet integriteti për shkak të neglizhencës së ekzekutivit. Kjo duhet kthehet në pikën 0. Kuvendi nuk duhet të shndërrohet nëpazar.Egziston Gjykata.Jemi kundër këtyre çështjeve.

**z.Naim Zejna:** Kemi thenë të shtyhet në mbledhjet e ardhshme, por jo në mbledhjen të radhës.Kemi kërkuar edhe ne të kthehet në pikën 0.Prona ka qenë diskutabile për regjistrim në librat mbi pronat. Nuk mund të votoj për ta legjitimuar një çështje nga 2006 e cila nuk ka qenë as e blerë e as me dokumentacion në rregullt.

**Fehmi Hysenaj:**Kuvendi nuk duhet t'i ik përgjëgjësisë.Nuk duhet lënë vjerrëqytatarët tonë për asnjë çështje.Zyrtari Ligjorë duhet të na jepë rekomandimin për këtë, por ai mungon.Jam që të kryhet kjo punë ashtu si jemi marrë veshë më herët. Le të zhvendosim pronën ashtu si është kërkuar dhe le të mbyllet kjo çështje.

**z.Isak Muslija:**Ftojë deputetët që nëse skemi informacion të abstenojnë. Kuvendi nuk udhëheq hetime për prona.Ne nuk e kemi informacion për uzurpim.Çdo shkelje e ligjit është krim.Nëse është uzurpim si mund t'i japim tash pronën të njejtit.Jemi duke marrë vendim të gabuar. Ne po e legalizojmë krimin.

**z.Fehmi Hysenaj:** Unë jam i interesuar që vendimi i Kuvendit, që e kemi votuar, të shkojë përpara.

**z.Reshat Mujota:** Pyes Naim Zejnëna ka qenë në KPF.Tash ka ndryshuar mendimin.Kthiemi në pikën 0 është çështje e gjykatës dhe jo kthim në pronën në Lagjen e pajtimit. Tani po e bashkangjesim edhe një uzurpimin.

Prona 313/3,313/4,313/5,313/6 është dhënë për varreza të fshatit Davidovc me vendim, më herët.

**Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj:** Konstatoj se janë 20 delegatë prezent për votim.Për aprovim janë 12 vota, 5 vota kundër (Isak Muslija, Reshat Mujota, Ruzhdi Jashari, Naim Zejna, Besnik Seferi), 2 vota abstenim (Skender Hysenaj, Rexhep Gashi). Me shumicën e votave si dhe me rekomandimin e KPF-së aprovohet Propozim-Vendimi për këmbim të pronës së paluajtshme komunale, sipas vendimit të Kuvendit Npi-01/272, të datës 24.11.2020 dhenë këmbim të përfshihet komplet parcela me numër P-333/3 dhe pjesa e mbetur të merret nga P-333/4 (të fillohet në kufinjë të parcelës fqinje-Sadik Abazit).

#### Pika 4

Propozim-Vendim për shpalljen me interes publik të ngastrave kadastrale Rancë, Rrugë, Nr.372/0, 373/0, pronë e Salih Halili dhe Shaban Halili — Rancë.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Prezantoi para Kuvendit Propozim-Vendimin për shpalljen me interes publik të ngastrave kadastrale Rancë, Nr.372/0, 373/0, pronë e Salih Halili dhe Shaban Halili — Rancë, sqarimet i ka dhënë Kryesja. Gjithashtu njoftoi se Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “ për “, 1 “ kundër “ dhe 1 “ abstenim “ i ka rekomanduar Kuvendit që ta aprovojë Propozim-Vendimin për shpalljen me interes publik të ngastarve kadastrale në Rancë.

#### **Diskutimet:**

**z.Isak Musliu:** Në bazë të emrit dhe numrit të fletës poseduese flitet për parcelën ku ka qenë Shtabi i UÇK-së.Nëse është kjo, jam për aprovim.

**z.Perparim Ramusa:** Në KPF e kemi diskutuar dhe këtë kemi rekomanduar që të aprovohet Propozimvendimi. Jam që Kuvendi ta aprovojë.

**z.Naim Zejna:** Prona ku është Shtabi është shpronësuar më heret.Parashtruesi kërkon shpronësimin e rrugës dhe prapa Shtabit rruga nuk ka nevojë të shpronsohet sepse ai prapë e shfrytëzon këtë.Nuk i pengon rruga.

**z.Isak Musliu:** Egzistojnë 3 rrugë.Aty nga UÇK -ja është shfrytëzu gati hektar përreth Shtabit.UÇK-ja ka shfrytëzuar atë pronë dhe tani parashihet ngritja e një kompleksi. Është fjala për krijimin e kushteve për të ardhmen.

**z.Naim Zejna:** Prona 7 ari nuk ka nevojë të shpronësohet sepse nuk e pengon asgjë pronarin.

**z.IsakMuslija:** Kjo pjesë duhet të shpronësohet sepse futet në kompleks.

Shefki Dauti:Duke marrë parasyshërendësinë që ka ai vend për Shtabin e UËK-së nuk duhet të ketë dilemë për shpronësim. Është fjala për 7 ari që është me interes.

**z.Reshat Mujota:** Kërkohen gjithësej 7 ari e 20m dhe është fjala për rrugë.Ajo është rrugë private prandaj nëse e rrethon nuk ka çasjenëShtab . Është e drjetë e tij.Çdo që ka të bëjë me luftën duhet ta përkrahim.

**z.Isak Musilija:** Ky person nuk ka interesa të veta aty ai ka ofruar gjithë pronën për interesa të kompleksuar lidhur me shtabin.

**z.Ruzhdi Jashari:** Shpronësimi ka ndodhë në 2016, në Rancë dhe Pjehershticë.,Kjo po bëhet për fushat tani.Në Rancë kemi pasur 2 shtëpi.Rruga përmbi 2 shtëpi ka qenë.Tani kemi shpronësimin të vëtëm një rruge që lidhet me rrugën kryesore. Është e drejtë të bëhet shpronësimi urgjentisht.

**z.Fehmi Hysenaj:** Kjo që mund të bëjmë sot është më e pakta për ato familje në Rancë.Jam për të funksionalizimin e investimeve në Rancë duhet pasur parasysh rendësinë për lirinë dhe UÇK-në.

**z.Muhamet Ademaj:** Jam që të shpronësohet pasi që kjo rrugë qenka me rëndësi.

**z.Rexhep Gashi:** Përkrah parafolësin se jemi vonuar për këtë deri tani .

**z.Skender Hyseni:** Kur është çështja për UÇK-në, jam që të bëhet gjithçka nga ne.Jam pro.

**Kryesuesja e Kuvendit znj. Mednia Brahaj; Konstatohet se janë 20 delegatë prezent për votim. Gjithashtu konstatohet se unanimisht ( 20 vota për ) aprovohet vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm i Ngastrës Kadastrale P-72809070-00373-0, me sipërfaqe prej 535 (pesëqind e tridhjetë e pesë) metra katrorë, të vendit të quajtur "Shullani" Shfrytëzimi aktual i parcelës "Pemishte e klasit të tretë" në Zonën Kadastrale – Rancë, Evidentuar pronë private e Shaban /Rifat/ Halili nga fshati Rancë.**

#### Pika 5

##### Propozim-Vendim për ndryshim të destinimit të shkollës dhe oborrit të shkollës në Llanisht

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Propozim-Vendimi për destinimin e Oborrit dhe Shkollës në fshatin Llanisht, ka ardhur nga Drejtoria për Arsim, bazuar në kërkesën që I është drejtuar. Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota " për ", 2 " abstenim " dhe me një votë " kundër " i ka rekomanduar Kuvendit që të aprovojë propozim-Vendimin e lartëcekur.**

Diskutimet:

**z. Isak Musliu:** Kemi objektin që lidhet prapë me UÇK-në. Kërkesa është nga organizatat e dalura nga lufta e UÇK-së. Aty është një lapidar i ndërtuar pa vendim të Kuvendit. Çka është kërkuar nga organizatat e dalura nga lufta e UÇK-së. Kërkesa është bërë pa konsultimin e OVL-së të Komunës së Shtimës. Nëse nuk e ka përgjegjësi këtë objekt OVL atëherë ai do të shfrytëzohet nga çdokush dhe mund të keqpërdoret me emër të OVL-së. Kërkoj që t'i jepet kompetenca menaxhuese OVL në Shtime, nëse aprovohet, sepse nuk mund të përjashtohet dega e OVL-ës-Shtime. Ruajtja dhe përgjegjësia duhet të jetë kompetencë e OVL-së. Mbikqyrja mund të bëhet nga kërkuesi-Departamenti për mbrojtjen e monumenteve-vlerave të luftës, por përgjegjësinë ta ketë dega e OVL-së-Shtime.

**z. Besnik Seferi:** Pse nuk është përfshirë OVL- Shtime. Kërkoj të shtyhet kjo pikë që të diskutohet me OVL-në, në Shtime.

**z. Fehmi Hysenaj:** Shtyrja nuk është e nevojshme. Kemi këtu një obligim-diskutim me qytetarët. Kërkoj të dnxirret në diskutim publik.

**z. Perparim Ramusa:** Organi kompetent për mbrojtjen e vlerave të luftës është Departamenti për mbrojtjen e vlerave të luftës. Unë jam që të aprovohet propozimi.

**z. Naim Zejna:** Shkolla është ndërtuar në vitet 60-ta. Ka qenë pronë private e kompenzuar. Shkolla është rindërtuar pas luftës sepse ka qenë e shkatërruar. Jam që t'i mbetet objekti rinisë, klubeve të ndryshme sportive dhe të jetë pronë e Komunës.

**z. Reshat Mujota:** Nëse kërkohet nga organizatat qëndër për t'i dhënë Agjencionit për mirëmbajtje të komplekseve, ky Agjencion nuk ka investuar askund në komplekse deri tani. Ose t'ia japin agjencionit ose shoqatave dhe jo tërthorazi.

**z. Isak Muslija:** Këtu nuk ka zgjidhje të problemit. Ka më shumë politikë pasi që është anashkaluar OVL, në Shtime. Kjo duhet të ketë kompetenca këtu dhe t'i përshkruhen përgjegjësitë.

**z. Ruzhdi Jashari:** Po thuhet se organizatat e luftës në Shtime nuk janë koordinuar. Këto janë çështje dakordance për çështje politike. Reçaku ende nuk është kthyer në një qëndër memoriale dhe nuk ka ende muze, që ka qenë i paraparë. Është thënë se shkolla do të shfrytëzohet nga DKA në vitin 2016 për organizatat e të rinjve. Si është e mundur t'ia japim të tjerëve. Duhet të shtyhet marrja e vendimit.

**z. Muhamet Ademaj:** Është mirë të presim për një kohë. Le të shrytëzohet si qëndër rekrative për të rinjtë.

**znj. Fatmire Ferati:** Është më e rëndësishme të ruhen objektet që kanë vlerë. Ato shkatërrohen nga qytetarët e pa ndërgjegjshëm. Nëse merret në menaxhim atëherë duhet jo vetëm të ruhen, por edhe të investohet. OVL, në Shtime, duhet të ketë listën e objekteve që janë shfrytëzuar nga UÇK-ja. Agjencionit t'i kërkohet llogari që të mbrohet objekti si duhet të jetë i shfrytëzueshëm për të gjithë.



**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi se me 11 vota për, 5 kundër dhe 4 abstenime Kuvendi merr vendim që Propozim-Vendimi për destinimin e Oborrit dhe Shkollës në fshatin Llanisht, të nxirret në diskutim publik për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, në bashkëpunim me Zyrën për Informim.**

#### Pika 6

##### Caktimi i lokacionit për vendosjen e shtatores së “Adem Jasharit”

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Sqaroi Propozim-Vendimin për përzgjedhjen e lokacionit për vendosjen e shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari, në Shtime, sipas propozimit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.**

Diskutimet:

**z.Naim Zejna:** Asnjë lokacion nuk plotëson kushtet. Te trekëndëshi, në qendër, duhet të hiqen ato investime që janë bërë e pastaj të vendoset shtatorja e Adem Jasharit. Te Sheshi i Dëshmoreve të hiqet pllaka e pastaj krijohet hapsirë, prandaj asnjëri lokacion I propozuar nuk është tani për tani i përshtatshëm.

**z.Lumni Amrushi, drejtori i DKRS;** Lokacioni është me rendësi, prandaj kemi kërkuar që Kuvendi të diskutojë. Shtatorja është me lartësi 3.20m. 1.20 është bazamenti.

**z.Ruzhdi Jashari:** Çështja e Adem Jasharit është me përmasa globale, sikur se Skënderbeu. Vendi duhet të korrespondojë me madhësinë. Sheshi është i vogël dhe pa heqjen e 3 të tytave nuk ka kuptim të vendoset shtatorja e Adem Jasharit. Kam propozuar të rrethohet objekti para Komunës dhe të vendoset shtatorja e jo të nxirret.

**z.Rexhep Gashi:** A është mirë të hiqen simbolet ku i kemi tytat dhe pllaka e dëshmoreve. Ku do të vendosen ato ?

**z.Fehmi Hysenaj:** Duhet hapur diskutimin më gjerë. Investimi duhet të bëhet kur paraprakisht e dimë se ku duhet investuar e jo kështu. Objekti para Komunës nëse rrethohet krijohet hapsirë mirë për shesh ku mund të vendoset shtatorja. Kjo është zgjidhja. Propozoj të vendi ku janë Varrezat e Dëshmoreve.

**z.Shefki Dauti:** Trekëndëshi është i mirë pasi ka frekuentim. Mirë është të dalë në diskutim publik.

**z.Isak Musliu:** Është mirë sikur të dilnin më shumë propozime për lokacionin nga drejtoritë e caktuara. Madje lokacione për të gjitha simbolet e luftës së UÇK-së. Jam për diskutim publik.

Muhamet Ademaj: Edhe unë propozoj që ta nxjerrim në diskutim publik.

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoj se Kuvendi unanimisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Propozim-Vendimin për përzgjedhjen e lokacionit për vendosjen e shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari, në Shtime, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në bashkëpunim me Zyrën për Informim.**

#### Pika 7

##### Informatë e përgjithëshme nga drejtoria për inovacion

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Fjalën ja dha Shpresa Tafa.**

**znj. Shpresa Tafa, drejtoreshë e IZHP;** Ka paraqitur para Kuvendit Informatën lidhur me punën dhe aktivitetet e kësaj drejtorie. Ajo, veç tjerash tha: Drejtoria ka filluar të punojë në kuadër të Komunës nga muaji mars 2019 dhe është drejtorja e parë në nivel të Republikës së Kosovës.

Drejtoria e Inovacionit dhe Zhvillimit të Projekteve ka vizion, mision dhe objektivat të cilat janë në harmoni me nevojat dhe kërkesat e të rinjëve inovator si dhe të gjithë personat e tjerë që kanë projekte kreative.

Inovacioni në kuptimin e tij modern është një ide e re, mendime krijuese, imagjinata të reja në formë të pajisjes ose metodës.

Paraqiti edhe qëllimin e Drejtorisë së Inovacionit dhe Zhvillimit të Projekteve, ku veç tjerash tha: Si qëllim më vete kjo drejtori ka ofrimin e një hapsireinovative ku nxënësit,studentet dhe të gjithë qytetarët me ide dhe njohuri të reja që krijojnë vlerë inovative do të zhvillojnë projektin e tyre,do të avancohen për tregun dhe do të punojnë veprimtarinë e tyre me sukses duke e bërë një qendër të gjallë ku njerëzit duan të jetojnë dhe punojnë.

Prezantoi edhe aktivitetet e zhvilluara, si: trajnimet, projektet e realizuara, pajisjet inovative nga “ MILENIUMI”,vendosja e paneleve solarae, bashkëpunimin me OJQ dhe organizatat rinore, shfrytëzimin e hapësirave nga të rinjt për aktivitete kreative dhe idetë e reja etj.

Diskutimet:

**z.Naim Zejna:** Mua më intereson numri i të punësuarve, sa është kostoja e kësaj drejtorie, cila është dobia e komunës. Përkundër projekteve që u cekën, ka qenë shqetësuese marrja e 4 klasëve dhe dy banjove në shkollën e mesme pa e pyetur fare Kuvendin. Kjo ka shkaktuar çrregullim në shkollë sa i përket ndërrimeve. Aktivitetet me organizatën “ TOKA “ janë realizuar në një masë, që është mire, por nuk mjafton. Unë shtrova dy pyetje: Sa është kostoja e kësaj drejtorie për komunën dhe cila është dobia e saj.

**z.Fehmi Hysenaj:** Informata është shumë e mangët. A është marrë pëlqim për vendosjen në shkollë dhe renovimin për këtë drejtori? Sa buxhet ka drejtorja? Projekti i shkollës, marrja e hapësirave duhet të kthehet në gjendjen që ka qenë.

**z.Ruzhdi Jashari:** Në informatë duhet të kemi sa të punësuar kjo drejtori, cilat janë projektet që ka realizuar si drejtori. Nëse kemi Sektor të inovacionit në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik atëherë nuk ka Drejtori të Inovacionit. Drejtorja duhet të paraqesë stafin. Informacioni është i mangët. Nuk prezntohet sa ka të punësuar kjo drejtori.Nëse kemi sektor të inovacionit ne DZHE nuk ka drejtori të inovacionit.Drejtorja duhet të paraqet stafin e drejtorisë nëse ka.Kërkojë sqarim a ka drejtor apo sektor.

**z.Rexhep Gashi:** Çfarë të mire kanë përfituar qytetarët nga kjo drejtori.Cili është stafi?

Muhamet Ademaj:Shkolla profesionale nuk e ka pyetur kush për vendosjen e drejtorisë së inovacionit.

**z.Besnik Seferi:** Aktivitetet janë të mangëta për këtë drejtori. Pajtohem me parafolësin Ruzhdi jashari. Organizatat kanë kërkuar vetëm lokacionin për aktivitete rinore dhe këto aktivitete nuk i ka zhvilluar drejtorja si në informat. Nuk është mire që në informatë të përfshihen aktivitete që nuk i ka realize kjo drejtori. Nëse janë realizuar atëherë sa ka qenë numri i pjesëtarëve të të rinjve në aktivitete, kur thuhet se ka pasur shumë.

**z.Shpresa Tafa:** Unë kam një vendim politik për emërim dhe i përgjigjem Kryetarit të Komunës. Për staf nuk vendosi sa duhet të jetë.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Në emër të Kuvendit, Arbreshën e falënderojmë për punën e sajë këtu në Kuvend, ndërsa i urojmë punë të mbarë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Shtime. Ju falënderoj për diskutimet, dhe për pjesëmarrjen e juaj në mbledhjen e Kuvendit, meqenëse diskutime tjera nuk ka mbledhjen e përfundoj në ora 14.00h.

Procesmbajtësi:

Ibrahim Demiri



Kryesuesja e Kuvendit

Medina Brahaj